

VENDIM
Nr.601, datë 10.9.2004

PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME
SHTETËRORE NË BASHKINË E LIBOHOVËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3 të nenit 8 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 "Për pronat e paluajtshme të shtetit", me propozimin e Ministrit të Pushtetit Vendor dhe të Decentralizimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që janë në juridiksionin territorial dhe administrativ të bashkisë së Libohovës, sipas propozimit të paraqitur nga këshilli i kësaj bashkie.

Lista që i bashkëlidhet këtij vendimi, ka 32 (tridhjetë e dy) fletë dhe përfundon me numrin rendor 166 (njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë).

2. Ndryshimet që mund t'i bëhen listës gjatë periudhës së afishimit, të pasqyrohen në listën përfundimtare të pronave, e cila miratohet nga Këshilli i Ministrave.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano